



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele**

PA1: 08-54

03.03.2026

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në pajtim me nenin 54, paragrafi (4) dhe nenin 104, paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-54 datë 16.2.2026 dhe Propozimin PA1 nr.08-54 datë 27.2.2026, në pajtim me Konkluzionin, nr.ark.02-774/3 datë 2.3.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 9-të mbajtur më 2.3.2026, miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen
e lejes për transmetim në radio

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare RAdiodifuzive (ShTR) RADIO 99 ShPKNjP Shkup, PA1 nr.0802-37 datë 7.2.2024 me ndërrim PA1 nr.0802-107 datë 6.3.2024.

Arsyetim

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (AShMA) në seancën e 7-të mbajtur më 18.2.2026, me Konkluzionin nr.ark.02-624/5 datë 18.2.2026, miratoi propozimin e dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë, PA1 nr.08-54 datë 16.2.2026 dhe inicoi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të ShTR RADIO 99 ShPKNjP Shkup, PA1 nr.0802-37 datë 7.2.2024 me ndërrimin PA1 nr.0802-107 datë 6.3.2024, për shkak se pas mbikëqyrjes së kryer të rregullt administrative, në Raportin me shkrim me nr.ark.05-636/1 datë 16.2.2026, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga AShMA, nuk ka përbushur detyrimin e nenit 80, paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LShMAAV), përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio AShMA-së.

Në lidhje me këtë, nga ana e AShMA-së më 19.2.2026, drejtuar transmetuesit të lartpërmendur është dërguar Shkresë PA Уп1 nr.08-54 datë 19.2.2026, për njoftim se nëse nuk paguan plotësisht kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për inicim të procedurës për heqjen e lejes,

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).



**Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги**

**ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија**

Тел. + 389 2 3103 400

**www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk**





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio. Njoftimi më 19.2.2026 është dorëzuar dhe në mënyrë elektronike në e-mail adresën zyrtare të transmetuesit, regjistruar si informacion për kontakt në RQRMV dhe në regjistrin e radiodifuzerëve që udhëhiqet nga Agjencia.

Megjithatë, më 24.2.2026 nga Sektori për financa dhe logjistikë, drejtuar mr. Dragica Ljubevska, person i autorizuar nga drejtori i Agjencisë, në pajtim me Autorizimin, nr.ark.03-5648/1 datë 29.12.2025, është dorëzuar Njoftim me nr.ark.05-636/2 datë 24.2.2026, se ShTR RADIO 99 ShPKNJ P Shkup më 24.2.2026, ka kryer pagesë në shumë prej 319.531,00 (treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e një) denarë, me të cilën transmetuesi e ka paguar plotësisht kompensimin vjeterot të lejes për transmetim në radio.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 22 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafët 1 dhe 10 të LShMAAV, në pajtim me nenin 54, paragrafi (4) dhe neni 104, paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-54 datë 16.2.2026 dhe Propozimin PA1 nr.08-54 datë 27.2.2026, në pajtim me Konkluzionin nr.ark.02-774/3 datë 2.3.2026, Këshilli i Agjencisë në seancën e 9-të mbajtur më 2.3.2026, vendoj ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Përktheu: Antoneta shabani